

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PD kërkon Komision Hetimor për KAYO-n, Balliu: Të hetohen partneritetet, kontratat dhe lidhjet me siguri në kombëtare - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/pd-kerkon-komision-hetimor-per-kayo-n-balliu-te-hetohen-partneritetet-kontratat-dhe-lidhjet-me-sigurine-kombetare/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 09:25:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 09:20:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	789c97918cde16dfe2a207aeaa969b7c063f70c3bd7d62aac4b1df7244ed2bb7
TEKSTI	c9660564b27572fbc01d157d7887cce380bc78e3b56ab80a6b1870d6dcc84f29
PAMJA	7d57c1abcb567ce7969874b94478f6f47ad37c724fa38373aad2f147f8491c30

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e04fcd2a3d5e20b242e43ea295d812a93dc654a4a4b0c59347fd647299da9da5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e4fff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e04fcd2a3d5e20b242e43ea295d812a93dc654a4a4b0c59347fd647299da9da5>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

PD kërkon Komision Hetimor për KAYO-n, Balliu: Të hetohen partneritetet, kontratat dhe lidhjet me sigurinë kombëtare

by Sport Sport — September 14, 2026 in Aktualitet, Politike

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Partia Demokratike dorëzon kërkesë për ngritjen e një Komisionit Hetimor për "KAYO"-n.

Deputeti Klevis Balliu deklaroi se zhvillimet e fundit kanë ngritur pikëpyetje serioze që lidhen me sigurinë kombëtare, kontrollin shtetëror dhe aktivitetin e kompanisë në sektorin e armëve dhe teknologjisë ushtarake.

Sipas Balliut, një nga emrat që kërkon verifikim të plotë është ai i Ron Yeffet, për të cilin deputeti ngre pyetje mbi marrëdhëniet e tij me struktura të lidhura me KAYO-n, si dhe mbi lidhjet e raportuara me rrethin e Edi Ramës.

"Emri i Ron Yeffet kërkon përgjigje. Po kështu kërkon verifikim çdo informacion mbi përfshirjen e tij në hetimet që lidhen me dosjen e AKSHI-t. Nëse kjo rrethanë konfirmohet nga organet kompetente, atëherë kemi një arsye edhe më të fortë që të zbardhen të gjitha marrëdhëniet ekonomike dhe institucionale", deklaroi Balliu.

Ai ka ngritur gjithashtu pikëpyetje mbi krijimin, më 23 mars 2026, të shoqërisë "Timak Horse Club", me pronar përfutues Ron Yeffet, dhe lidhjen e aktivitetit të saj me "Equos Resort" në Petrelë.

Balliu thekson se kronologjia mes krijimit të kompanisë dhe zhvillimeve të mëvonshme që lidhen me pasuritë e Ergys Agasit dhe "Equos Resort" nuk përbën, në vetvete, provë të një vepre penale, por sipas tij është një rrethanë që duhet verifikuar nga institucionet kompetente.

Deputeti i PD-së kërkon që SPAK të verifikojë çdo lidhje të mundshme mes Yeffet, Agasit, "Equos Resort", "Timak Horse Club" dhe personave apo subjekteve të përfshira në hetimet e AKSHI-t.

Në fokusin e Komisionit Hetimor, sipas Balliut, duhet të jetë edhe mënyra se si janë përzgjedhur partnerët e KAYO-s, kontratat e lidhura, kontrolli shtetëror mbi aktivitetin, importi dhe eksporti i armëve, si dhe respektimi i detyrimeve ndërkombëtare dhe interesit të sigurisë kombëtare.

"Parlamenti nuk po kërkon të zëvendësojë SPAK-un. SPAK duhet të hetojë çdo dyshim për vepra penale. Parlamenti ka detyrimin kushtetues të ushtrojë kontrollin parlamentar dhe të zbardhë përgjegjësinë politike dhe institucionale", tha Balliu.

Ai i ka bërë thirrje qeverisë që të votojë pro Komisionit Hetimor dhe të vendosë në dispozicion të tij të gjithë dokumentacionin.

"Nëse nuk ka asgjë për të fshehur, pse duhet të trembet qeveria nga hetimi parlamentar? Nëse KAYO është krijuar në interesin e mbrojtjes së vendit, atëherë transparencën duhet të jetë a plotë"

TË FUNDIT

PD kërkon Komision Hetimor për KAYO-n, Balliu: Të hetohen partneritetet, kontratat dhe lidhjet me sigurinë kombëtare

SEPTEMBER 14, 2026

Protesta te Zogu i Zi/10 të shoqëruar, tubimi transferohet te Komisariati nr.1

SEPTEMBER 14, 2026

Bie numri i nxënësve në Vlorë, në bankat e shkollës ulen dhe fëmijë ukrainas

SEPTEMBER 14, 2026

Alarm për bombë të "Edith Durham" në ditën e parë të shkollës! Antiterrori prangos autorin e thirrjes

SEPTEMBER 14, 2026

Rregullorja e GJKKO-së për mediat në Kushtetues! AGSH depoziton padinë, kërkon shfuqizimin

SEPTEMBER 14, 2026

Tension te Zogu i Zi/ Protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre

SEPTEMBER 14, 2026

Detaje të reja nga ngjarja në Roskovec/ I ra vjehrrit me çekic, shpallet në kërkim daja i deputetes Zegjine Çausi

SEPTEMBER 14, 2026

Nisja e viti të ri shkollor shkakton kaos në qarkullim, rradhë kilometrike në kryeqytet deri në afërsi të Paskuqanit

SEPTEMBER 14, 2026

Kërkime për Alket Rizain në Greqi/ Dy persona të arrestuar pas përplasjes me armë pranë një beach bar-i

SEPTEMBER 14, 2026

Horoskopi ditor, e hënë 14 shtator 2026/ Zbuloni çfarë parashikojnë yjet për secilën shenjë


SEPTEMBER 14, 2026

ngjarjet më të mëdha të mëngjesit të 10 janarit, si dhe tërësinë e ditës së protestave.

Balliu e mbylli deklaratën me një paralajmërim politik: "Kur bëhet fjalë për armë, para publike dhe sigurinë kombëtare, askush nuk mund të jetë mbi ligjin. As Edi Rama, as njerëzit pranë pushtetit dhe asnjë kompani private. Shteti shqiptar nuk mund të jetë mburojë për askënd".

Previous Post

Protesta te Zogu i Zi/10 të shoqëruar, tubimi transferohet te Komisariati nr.1



report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarën

0 SHARES



Identifikohet shqiptari i vrarë në Itali/ E lidhën dhe e ekzekutuan në makinë, automjetin më pas e hodhën në lumë

0 SHARES

© 2025 REPORT.AL

Aktualitet / OP-ED / Politike / Rajon / Showbiz / Sociale / Shëndet / Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.